



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**УСТАВНИ СУД**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

---

Prishtinë, më.14 shkurt 2012  
Nr.Ref.:RK198/12

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**Rasti Nr. KI 128/11**

Parashtrues

**Ismet Boshnjaku**

**Vlerësim i**

**Aktgjykimit të Gjykatës Supreme (Rev. Nr. 225/2007), të 25 shtatorit 2007**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

E përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar  
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Ivan Čukalović, gjyqtar  
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe  
Iliriana Islami, gjyqtare

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Parashtrues është z. Ismet Boshnjaku nga Batllava, Podujevë.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi e konteston Vendimin e Gjykatës Supreme (Rev. Nr. 225/2007), të 25 shtatorit 2007, që i ishte dorëzuar më 15 janar 2008.

## **Objekti i çështjes**

3. Parashtruesi pohon që “i është shkelur e drejta e tij themelore e punës, e garantuar me nenin 49.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës”.
4. Parashtruesi kërkon nga Gjykata Kushtetuese që “ta anulojë Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. Nr. 225/2007, të 25 shtatorit 2007”, dhe “ta miratojë” kërkesën [e tij] për ta kthyer në vendin e punës”.

## **Baza juridike**

5. Neni 113.7 i Kushtetutës, nenet 46, 47, 48 dhe 49 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe rregulli 56.2 i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatë**

6. Parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) më 7 tetor 2011.
7. Më 16 janar 2012, Kryetari e caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Ivan Čukalović (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Gjyljeta Mushkolaj.
8. Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues më 18 janar 2012, dhe i rekomandoi Gjykatës për papranueshmëri të kërkesës.

## **Përmbledhje e fakteve**

9. Parashtruesi kishte marrëdhënie pune me NSH “Llapi”, e cila u ndërpre diku në vitin 1991, pas pothuaj 13 vjetësh.
10. Për t’i mbrojtur interesat dhe të drejtat e tij për të cilat pretendonte se i ishin shkelur, parashtruesi filloi procedurë gjyqësore në Gjykatën Komunale në Podujevë, pastaj në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë dhe në fund në Gjykatën Supreme.
11. Në të vërtetë, më 25 shtator 2007, Gjykata Supreme (Rev. Nr. 225/2007) e refuzoi ankesën e parashtruesit kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut (Ac. Nr. 1043/2006, të 10 majit 2007).

## Vlerësimi i pranueshmërisë

12. Për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe në rregullin 36 të Rregullores së punës.
13. Gjykata konsideron se nga organet publike të Republikës së Kosovës mund të kërkohej të përgjigjen vetëm për faktet dhe aktet që kanë ndodhur pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës, pra pas 15 qershorit 2008. Si rrjedhojë, Gjykata nuk mund ta shqyrtojë një kërkesë që ka të bëjë me ngjarjet që kanë ndodhur para hyrjes së Kushtetutës në fuqi (shih Aktvendimin e Gjykatës për Papranueshmëri në Rastin Nr. 18/10, Denić dhe të tjerët, të 17 gushtit 2011).
14. Kjo çështje nuk bie nën juridiksionin kohor të Gjykatës Kushtetuese pasi Aktgjykimi i Gjykatës Supreme (Rev. Nr. 225/2007), i 25 shtatorit 2007, i ishte dorëzuar parashtruesit më 15 janar 2008, pra para 15 qershorit 2008, data e hyrjes së Kushtetutës në fuqi.
15. Përveç kësaj, rregulli 36.3 (h) parashikon që *“Po ashtu një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme”* nëse *“kërkesa nuk është racione temporis në pajtim me Kushtetutën”*. Prandaj, Gjykata konsideron që kërkesa është e parashkruar *“ratione temporis”*.

## PËR KËTO ARSYE

Në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, dhe rregullit 36.3 (h) të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese njëzëri

## VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese;
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtari raportues**

Almiro Rodrigues



**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Prof. dr. Enver Hasani

